



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE  
KËSHILLI KOMBËTAR PËR SHOQËRINË CIVILE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . \_\_\_\_\_

**PROCESVERBAL**

**Takim pune i anëtarëve të shoqërisë civile të  
Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile**

Më datë 28 shkurt 2018, ora 12:35, pranë ambjenteve të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) u zhvillua një takim pune me anëtarë të shoqërisë civile të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC), përfaqësues nga AMSHC dhe eksperte e Asistencës Teknike.

Në takim marrin pjesë:

**Anëtarë të shoqërisë civile të KKSHC-së:**

1. Z. Blendi Dibra
2. Znj. Arta Dyrmishi
3. Znj. Afërdita Seiti
4. Z. Ali Coka
5. Znj. Zana Vokopola
6. Z. Vladimir Thanó
7. Z. Ergys Gezka
8. Znj. Iris Luarasi
9. Znj. Mirela Koçi
10. Znj. Emanuela Zaimi

**Përfaqësues nga AMSHC:**

1. Z. Andi Luga

**Ekipi i Asistencës Teknike:**

1. Znj. Christine Leiser

12:30 – Z. Blendi përsëherë të pranishmit dhe filloi diskutimin me anëtarët për pikat e propozuara të axhendës për mbledhjen që do të zhvillohet më datë 6 mars 2018.

Ai i kërkoi anëtarë të shoqërisë civile të KKSHC-së të caktuar në grupet e përbashkëta të punës me përfaqesues të institucioneve publike, për të prezantuar punën përgatitore për secilën çështje.

12:36 – Lidhur me amendime të Ligjit për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse (OJF), fjalën e merr z. Vladimir dhe shprehet se nuk ka iniciativa konkrete për ndryshimin e Ligjit në kuadër të regjistrimit, çregjistrimit dhe funksionimit të OJF-ve.

12:46 – Znj. Christine u kërkoi të pranishmëve të jenë të qartë me strukturën e takimit. Gjithashtu, ajo u bëri të ditur anëtarëve të pranishëm se ekipi i asistencës teknike ka përgatitur një Udhërrëfyes të rishikuar, i cili përbëhet prej rreth 60 faqe.

Ky dokument është dërguar në Kryeministri, ku përfshihen: indikatorë; afate kohore; ministritë përgjegjëse etj. Ajo u tha anëtarëve se dokumenti nuk është shpërndarë, për arsye se nuk kanë marrë komente nga Kryeministria.

Në mbledhjen e Këshillit, datë 6 mars 2018, do të bëjë prezantimin e këtij Udhërrëfyesi për 20 minuta.

Ajo shprehet: “Na duhet një analizë aktuale për vështirësitë e hasura lidhur me Ligjin për financimet. Kështu që duhe të flasim me një zë.”

Znj. Christine parashtroi hapat e radhës që do të ndiqen:

- Deri më datë 13 prill 2018 do të zhvillohen katër konsultime publike me OSHC-të në qytetet ku u zhvilluan edhe më parë (Dhjetor 2017): Tiranë, Vlorë, Shkodër dhe Korçë.
- Të kërkohet heqja e kushtit/kërkesës që në një OJF të jetë një person i regjistruar.

Ajo shtoi: “Kemi qenë në Ministrinë e Drejtësisë dhe na informuan se për këtë vit dhe vitin tjetër nuk ka ndonjë ligj për amendim. Pra, një nga kërkesat të jetë, që ligjet me ndryshimet duhet në regjistrohen në Ministrinë e Drejtësisë.” Znj. Christine vazhdon: “Kryeministria kërkoi që Udhërrëfyesi i rishikuar të miratohet në Qershor 2018 dhe ju keni një rol shumë të rëndësishëm në monitorimin dhe zbatimin e tij.”

13:03 – Merr fjalën znj. Mirela, e cila flet mbi amendimet e projektligjeve për financimin e OSHC-ve në nivel qendror e vendor si dhe për taksimi i OJF-ve / TVSH dhe paketën fiskale. Znj. Mirela shprehet se brenda datës 2 mars 2018, sëbashku me znj. Zana do të dërgojnë me e-mail për anëtarët e shoqërisë civile në Këshill prezantimin që do ta prezantojnë në mbledhjen e datës 6 mars 2018.

13:07 – Në vijim të diskutimit mbi amendime të Ligjit për regjistrimin e OJF-ve, fjalën e merr përsëri z. Vladimir, i cili shprehet se prezantimin në mbledhje të kësaj teme do ta zhvillojë ai. Ai pyet nëse është urgjente ngritja e këtij grupi pune apo të bëhen më parë takime konsultative me grupet e interes. Gjithashtu ai shtron pyetjen nëse OJF-të duhet të regjistrohen në Gjykatë ose jo.

Znj. Iris thotë se ka tryeza konsultimi edhe për regjistrimin e OJF-ve dhe se sugjerohet që OJF-të të regjistrohen apo çregjistrohen pranë gjykatave të rretheve. Në vijim znj. Iris shprehet se sëbashku me z. Altin, brenda datës 2 mars 2018 do t'i dërgojnë me e-mail anëtarëve të shoqërisë civile në Këshill prezantimin e grupit të tyre.

Edhe z. Vladimir do t'i dërgojë me e-mail anëtarëve, prezantimin e tij më datë 2 mars 2018.

13:30 – Lidhur me projektligjet për sponsorizimet dhe ndërmarrjet sociale, fjalën e merr znj. Emanuela, e cila paraqet sfidat për këtë temë.

13:32 – Znj. Christine u thotë të pranishmëve se do t'ia dërgojë me e-mail Udhërrëfyesin e rishikuar.

13:33 – Lidhur me pikën tjetër të axhendës mbi “Përmirësimin e Manualit të Shërbimeve Mjedisore”, fjalën e merr z. Ali, i cili prezantimin e tij për mbledhjen e datës 6 mars 2018 do t'ia dërgojë me e-mail anëtarëve të shoqërisë civile në Këshill brenda datës 4 mars 2018.

Znj. Christine do të përgatisë pikat e tjera të axhendës “Prezantimin e Udhërrëfyesit të rishikuar” dhe “Konsultimet publike”.

13.37 – Në vijim, për mbledhjen e datës 6 mars 2018, z. Blendi do të bëjë një prezantim mbi organizimin e Konferencës së Parë Kombëtare për Zhvillimin e Shoqërisë Civile. Ai gjithashtu i kërkoi AMSHC-së të bëjë prezantimin e buxhetimit të fondit për KKSHC-në lidhur me mbulimin e shpenzimeve të parashikuara sipas Kalendarit të aktiviteteve për 2018.

13:40 – Znj. Christine i drejtohet anëtarëve të pranishëm duke u thënë se për këtë vit Këshilli ka në dispozicion 600.000 lekë për zhvillimin e aktiviteteve deri në muajin Qershor. Mbajtja e Konferencës kombëtare është në interes të AMSHC-së dhe do e mbështesë.

13:45 – Takimi mbyllet.